



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE

### NJOFTIM PUBLIK

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 173, datë 7.3.2003, “Për emërimin, lirimn ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të Ministrit, VKM nr. 508, datë 13.09.2017, ”Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, Urdhërit nr. 494, datë 15.11.2017 “Për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtuesve të drejtorive rajonale të shëndetësisë dhe drejtuesve të shëndetit publik”, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale shpall konkursin e hapur për pozicionin “Drejtor” në drejtori rajonale të shëndetësisë dhe drejtori të shëndetit publik, përkatësisht në:

#### Drejtori Rajonale të Shëndetësisë

1. Durrës
2. Elbasan
3. Fier
4. Gjirokastrë
5. Korçë
6. Kukës
7. Lezhë
8. Shkodër
9. Vlorë
10. Berat
11. Dibër

#### Drejtori të Shëndetit Publik

1. Krujë
2. Peqin
3. Librazhd
4. Gramsh
5. Mallakastër
6. Lushnjë
7. Tepelenë
8. Përmet
9. Pogradec
10. Kolonjë
11. Devoll
12. Tropojë
13. Has

14. Mirditë
15. Kurbin
16. Malësi e Madhe
17. Pukë
18. Sarandë
19. Delvinë
20. Skrapar
21. Kuçovë
22. Bulqizë
23. Mat
24. Kavajë

## **DOKUMENTACIONI PËR APLIKIM DHE AFATI I DORËZIMIT TË APLIKIMIT**

Kritere të përgjithshme që duhet të plotësojnë kandidatët që aplikojnë për pozicionin “Drejtor”:

- a. Të zotërojë diplomë të nivelit master shkencor, preferohet në Mjekësi/Shkenca Natyre/Shkenca Shoqërore apo fusha të tjera të menaxhimit;
- b. Të ketë përvojë pune minimumi 3 vjet;
- c. Preferohet të ketë eksperiencë pune në drejtim ose menaxhim;
- d. Të mos jetë marrë ndaj tij masë disiplinore për shkelje të rënda në kryerjen e detyrës;
- e. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

### **Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:**

- a. Letër interesi për pozicionin në të cilin po konkurron;
- b. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me formatin e përcaktuar në shtojcën 1 (bashkëlidhur kësaj rregulloreje);
- c. Tabelën e plotësuar me të dhënat për aplikant sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 2 (bashkëlidhur);
- d. Formulari i vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore;
- e. Dy referenca nga punëdhënës apo bashkëpunëtorë të mëparshëm;

**Kujdes!** Mosdorëzimi dokumentave të mësipërm është kusht skualifikues.

Vlerësimi i mëtejshëm i kandidatëve që plotësojnë kriteret e përgjithshme do të bëhet nëpërmjet testimit me shkrim dhe intervistës me gojë.

### **Fushat e njohurive mbi të cilat do të zhvillohet testimi me shkrim**

**Kandidatët do të testohen me shkrim rreth njohurive mbi legjislacionin e mëposhtëm:**

- a. Ligjin nr. 10138, datë 11.05.2009 “Për shëndetin publik”, i ndryshuar;
- b. Ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”;
- c. Ligjin nr. 10107, datë 30.03.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- d. Ligji nr. 8876, datë 04.04.2002 “Për shëndetin riprodhues”, i ndryshuar;

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a. Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me pozicionin për të cilin aplikon;
- b. Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për pozicionin ku aplikon;

Dokumentacioni i kandidatëve do të dorëzohet pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

**Afati i dorëzimit të aplikimeve: 18 Dhjetor 2017**

Kandidatët do të njoftohen nëpërmjet postës elektronike për informacione në lidhje me plotësimin e kriterëve, fazat e testimit, datën dhe vendin ku do të zhvillohet konkurimi nga sekretariati teknik.

Më shumë informacion mund të gjeni në faqen web të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, [www.puna.gov.al](http://www.puna.gov.al) dhe të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale [www.shendetesia.gov.al](http://www.shendetesia.gov.al)